

VENDIM
Nr. 653, datë 23.11.2023

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 642, DATË 29.10.2021, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KRIJIMIN, ORGANIZIMIN DHE
FUNKSIONIMIN E AGJENCISË SHTETËRORE TË PROGRAMIMIT
STRATEGJIK DHE KOORDINIMIT TË NDIHMËS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 6 e 18, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Shkronja “ç”, e pikës 2, të kreut III, të vendimit nr. 642, datë 29.10.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës”, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“ç) të ketë përvojë pune jo më pak se 7 vjet;”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama